

EPO GRUND S



PËRSHKRIMI

Astar epoksid dy komponentësh, i forcuar me poliamid, që përmban fosfat zinku dhe ka veti të shkëlqyera ndaj korrozionit

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Tharje e shpejtë
- Ngjitje në bojë alkide
- Mbrojtje nga korrozioni
- Ngjitje e shkëlqyer në sipërfaqe metalike
- Rezistencë të lartë kimike ndaj gërryerjes (konsumimit)
- Ngjitje perfekte dhe depërtim i lartë në sipërfaqe me ndryshk

PËRDORIME TË REKOMANDUARA

Rekomandohet të përdoret si astar mbi të gjitha sipërfaqet metalike që janë të destinuara për përdorim në ambiente të brendshme dhe kryesisht të jashtme. Përdoret sidomos në ato raste kur kërkohet rezistencë shumë e lartë ndaj ndryshkut dhe kur sipërfaqet metalike janë të ekspozuara ndaj agentëve korrodues. Përdoret për lyerjen e konstruksioneve metalike që janë të destinuara për përdorim në ambiente industriale, si kabanone, ura, shkallë, çisterna metalike, makineri, etj.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Rezina	Rezinë alkide
Densiteti EN ISO 2811-1	Komp. A 1,45±0,02 gr/ml Komp. B 1,05±0,02 gr/ml
Mbetja e thatë EN ISO 3251	70%
Raporti i përzierjes	3 : 1
Shkalla e hollimit	10 – 20%
Viskoziteti	115 ± 5 KU
Koha e tharjes	1 - 2 orë Në varësi edhe të kushteve të ambientit dhe diluentit të përdorur
Koha për rilyerje	2 - 4 orë Në varësi edhe të kushteve të ambientit dhe diluentit të përdorur
VOC në produktin e gatshëm (Di rektiva Europiane 2004/42/EC) (g/l)	≤ 100
VOC emetimi në ambient, dhomë simulimi ISO 16000 (mg/m3)	≥ 20

PËRGATITAJ E PRODUKTIT

Bëni përzierjen e dy komponentëve dhe më pas hollimin e produktit duke përdorur solventin e duhur deri në viskozitetin e përshtatshëm për aplikim. Rekomandohet që përzierja e produktit me solvent të bëhet duke përdorur një mikser elektrik.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Pastroni sipërfaqet nga boja e vjetër e dëmtuar, e pa ngjitur dhe pjesët e ndryshkura duke bërë zmerelimin e sipërfaqes. Me anën e procesit të larjes eliminoni të gjithë pluhurat e krijuar nga procesi i zmerimit si dhe elemente të tjera që pengojnë ngjitjen si graso, vajra, etj

APLIKIMI I PRODUKTIT

Aplikimi i produktit Epo Grund S, bëhet me anën e një pistolette me ajër, me furçë ose me rrul. Fillimisht hidhni produktin e përgatitur në enën mbajtëse. Më pas me anën e pistoletës bëhet hapja e produktit mbi sipërfaqen e metalit. Aplikimi bëhet duke aplikuar dy shtresa të njëpasnjëshme në mënyrë që të bëhet mbulimi sa më i mirë i sipërfaqes së metalit. Sigurohuni që të përfitohet spessori i duhur i shtresës në mënyrë që të arrihet mbrojtja maksimale e metalit.

PAKETIMI

Kanace 4Kg

RUAJTJA

36 muaj, me kusht që kanaçet të jenë të mbyllura dhe në kushte normale ruajtjeje.

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gëlltitet lajmëroni dhe kërkoni ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e ambalazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

SHËNIME

- Rekomandohet që të shmanget aplikimi i produktit në temperatura nën 5°C

